



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni pranveror

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Mbledhja nr. 44/2012
Prishtinë, më 16. 01. 2012, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, sala N-225

P R O C E S V E R B A L
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK, INFRASTRUKTURË,
TREGTI DHE INDUSTRI

Në mbledhje morën pjesë: Zenun Pajaziti - kryetar, Teuta Sahatqija, Sala Berisha - Shala, Fikrim Damka, Lutfi Zharku, Hashim Deshishku, Berat Buzhala, Visar Ymeri, Ramiz Kelmendi, Myzejene Selmani dhe Biserka Kostiq.

Pjesëmarrës të tjerë: Ukë Gashi –ZPRK dhe Visar Perveza – Gazeta “Koha Ditore”.

Stafi mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Muhamet Morina, Besim Haliti dhe Brikena Hoxha- konsulente e Komisionit.

Mbledhjen e kryesoi: Zenun Pajaziti - kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 15.12.2011;
3. Shqyrtimi i Raportit të punës së Komisionit për vitin 2011;
4. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 15.12.2011

Procesverbali nga mbledhja e datës 15.12.2011 u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Raportit të punës së Komisionit për vitin 2011

Kryetari – Tha se për këtë mbledhje kemi caktuar një pikë të vetme, atë për miratimin e Raportit vjetor të punës së Komisionit për vitin 2011. Raporti është hartuar nga stafi mbështetës i Komisionit, duke u konsultuar edhe me mua si kryetar. Në këtë Raport janë paraqitur aktivitetet e shumta të Komisionit me disa të dhëna statistikore, duke filluar nga numri i shqyrtimeve të projektligjeve, ku ceku se janë miratuar të gjitha projektligjet që kanë ardhur nga Qeveria gjatë vitit 2011 dhe shumë aktivitete të tjera, siç janë: shqyrtimi i raporteve të punës së agjencive që i raportojnë Komisionit, organizimi i disa konferencave apo tryezave që kishin të bëjnë me sferën e përmirësimit të legjislacionit për lehtësimin e zhvillimit të biznesit dhe në të mirë të zhvillimit ekonomik të vendit. Në fund, kryetari falënderoi stafin mbështetës të Komisionit dhe konsulencën e ofruar nga partnerët, për punë dhe angazhim gjatë vitit 2011.

Myzejene Selmani – Tha se gjatë vitit që lamë pas kemi punuar shumë, mirëpo jemi përballur me sfida të ndryshme. Vlen të theksohet puna në amendamentimin e projektligjeve, të cilat është dashur të ndryshohen apo të plotësohen mbi 40% të tyre. Deputetja Selmani i sugjeroi Komisionit që të bëjë punë më të madhe në kohën kur kemi para vetes shqyrtimin e projektligjeve në parim në Komision dhe propozoi, që nëse është e nevojshme në atë kohë të kthehen projektligjet e Qeverisë, e jo pasi të kalojnë leximin e parë në Kuvend, sepse pastaj duhet ndryshuar krejt projektligjin. Ajo kërkoi nga deputetët që të punohet më shumë në aspektin kualitativ të amendamentimit, e jo vetëm në atë kuantitativ, sepse pastaj ligjet nuk po gjejnë zbatim në praktikë.

Ramiz Kelmendi – Kërkoj që në këtë vit të punojmë më shumë në aspektin e shqyrtimit të çështjeve që ndihmojnë prodhuesit vendorë, duke bërë tryeza të hapura dhe diskutime nga aktorë kryesorë të biznesit në Kosovë. Ai shfaqti shqetësimin në lidhje me taksat e larta në ambalazhimin e materialit prodhues dhe TVSH-së në makinerinë prodhuese, ku propozoi që t'i bëhet trysni Qeverisë, që t'i ndryshojë këto politika në favor të një mjedisi më të mirë për investitorë. Në fund, ai tha se është dashur që të ngulim këmbë në kohën e amendamentimit të Projektligjit për AKP-në dhe të bëhet trysni më e madhe në nivel komunal, sepse kur ta kemi një mbikëqyrje më të mirë, do të kemi edhe një biznes më të mirë.

Kryetari – Tha se ky është vetëm një Raport përshkruar i aktiviteteve të Komisionit për vitin 2011 për të arriturat e tij, ndërsa vlerësimin e punës e bëjnë aktorë të tjerë e jo vetes ne si Komision. Po ashtu, ai shtoi se Komisioni gjatë vitit 2011 ka organizuar 4 tryeza dhe konferenca, dhe pikërisht me idenë e z. Kelmendi për përmirësimin e legjislacionit për prodhuesin vendor, por ai vetë nuk ka marrë pjesë në to. Në fund kërkoi nga deputetët që të miratojnë Raportin vjetor të punës së Komisionit për vitin 2011.

Pas debatit, Komisioni unanimitet nxori këtë

Përfundim

Miratohet Raporti vjetor i punës së Komisionit për vitin 2011.

4. Të ndryshme

Çështjet vijuese.

Mbledhja përfundoi në orën 11:30.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Zenun Pajaziti

Kryetar i Komisionit